

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kreshnik Spahiu: Nga mushkat me hashash te jahtet luksoze, metamorfoza e zengjineve të rinj - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/kreshnik-spahiu-nga-mushkat-me-hashash-te-jahtet-luksoze-metamorfoza-e-zengjineve-te-rinj/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:22:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:14:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f55f83b93dc7276636e7c0e34b13ee4acfedb67ec873d7d8de1e7b0eb524f43d
TEKSTI	fd928fff88f50523b37a64c08d4930dc45fc4c8733fd9ec86448bf85a88b3686
PAMJA	6b3fe9fcdb6b42ee758aecfcfb35458ab01f0cb995b82e7f6eddaf7e8f94bc24

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	51406c62f30023971adfb19b084b64fd179db00c033571eaed49591cca5388c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/51406c62f30023971adfb19b084b64fd179db00c033571eaed49591cca5388c

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Kreshnik Spahiu: Nga mushkat me hashash te jahtet luksoze, metamorfoza e zengjinëve të rinj

by Lajm Lajm — September 18, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Ju kam shkruar shpesh për Janaqin por ai është transformuar tashmë. Ai është modeli si i shndëron pasuria zengjinët e rinj shqiptarë.

Kur kthehem nga Ksamili për në Tiranë, e kam zakon që të ndaloj tek hoteli me 5 yje i Janaqit minoritar grek që kishte pushtuar bregun dhe detin me dokumenta falco, a thua sikur gjyshin e kishte pasur delfin..

Ndjej një lloj adrenaline kur shoh me sytë e mi evolucionin e Darvinit: si transformohet majmuni në njeri dhe më pas metamorfozën e shndërrimit të një zengjini të ri nga njeri në surat majmun.

E gjeta në parking Janaqin që po i tregonte të dashurës 30 vjet më të re një makinë Porsche Macan që e kishte mbështjellë me fjongo si dhuratë për ditëlindjen e saj.

Ajo e ardhur nga një fshat malor ndjehej e lumtur nën krahët dhe sqetullat plot lesh të Janaqit, i cili e ka bërë traditë që bën dush shumë rrallë.

Sapo më pa Janaqi, u hodh dhe më përqafoi, por gati sa nuk më helmoi, sepse kishte ngrënë shumë hudhra.

Hoteli me 5 yje i Janaqit s'kishte pësuar asnjë ndryshim.

Që kur shiti mallin e fundit me drogë në 2014 dhe mobiloi hotelin, nuk kishte bërë asnjë investim.

Papritmas plasi ulërima e së dashurës, sepse poshtë makinës Porsche kaluan 3 minj të mëdhenj, të cilët dukeshin të moshuar, sepse ecnin ngadalë. Ambienti është shumë i pisët dhe minjtë i shikon shpesh edhe në det.

Nga parkingu shkuam në beach bar dhe ishin të njëjtat tavolina dhe karrige.

Unë mora një gotë Prosecco dhe vajta të ulem në shezlong buzë detit.

U ula diku anash, sepse zhuli i dyshekëve ishte me harta dhe kisha shumë neveri, por pantallonat e bardha m'u bënë gjithë ndryshk nga hekurat. Tentova të çohesha, por u rrëzoja, sepse këmba ishte aq e ndryshkur sa u thye.

Ndërkohë, nga larg dëgjoj Janaqin që shante një turist francez dhe i thonte në shqip: "Ha një mut, po s'të pëlqeu bifteku, se ju francezët nuk merrni vesh nga shija e mishit."

TË FUNDIT

Kreshnik Spahiu: Nga mushkat me hashash te jahtet luksoze, metamorfoza e zengjinëve të rinj

SEPTEMBER 18, 2026

Erion Veliq del nga qelia, shtrohet në një spital privat

SEPTEMBER 18, 2026

Zjarr në zonën e Sektorit Rinia në Durrës

SEPTEMBER 18, 2026

Bashkëshortja u arrestua për përvetësimin e 69 mln lekëve, Fetah Mataj emërohet përgjegjës në Bashkinë Durrës

SEPTEMBER 18, 2026

Makina përplaslet me barrierat, plagoset një grua dhe një fëmijë

SEPTEMBER 18, 2026

Ish-bashkëshortja e dajës së Zegjine Çaushtit: E mësonte ai

SEPTEMBER 18, 2026

Debati për pagat/ Rama thirrje gjyqësorit: Ejani të flasim!

SEPTEMBER 18, 2026

Spartak Ngjela zbulon 'kurën' e xhelozisë: Lëre të dashurën të shkojë me dikë tjetër

SEPTEMBER 18, 2026

Tentativë vrasjeje, drogë dhe municion luftarak, arrestohen në Itali dy shqiptarë

SEPTEMBER 18, 2026

Ndizen tensionet në Prishtinë para nisjes së protestës/ Policia kërkon dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë

SEPTEMBER 18, 2026

Turisti francez kishte thyer një dhëmb duke tentuar të kafshonte dhe përtypte mishin brazilian të skaduar prej 3 vjetesh.

E tërhoqa veç Janaqin për të shmangur ndonjë skandal, sepse pashë që djali i Janaqit futi një thikë në xhep dhe u afrua aty pranë.

“Ejani, pimë ndonjë gotë”, ju thashë, „dhe më tregoni çfarë investimi keni bërë këto kohë për rinovim.”

Janaqi më pa i habitur dhe nxori celularin për të më treguar një video.

Kreshnik më tha: “Të gjitha lekët që kam fituar i kam hedhur për të blerë këtë jahtin.”

Unë u mrekullova dhe i thashë: “Sa bukur, këtu do shëtisësh turistët.”

“Jo mo, ç’a lesh turistësh, o burazer. Unë e kam blerë për veten, që të dal në det me të dashurën, se ajo nuk di not, por i pëlqejnë dallgët.”

Ndërkohë, ajo u skuq nga turpi dhe i futi një të pickuar në bark Janaqit.

Unë isha disi i lodhur dhe u thashë që po shkoj t’i fus një dush në dhomë përpara drekës.

Dhoma ishte njësoj si 12 vjet më parë dhe çdo mobilje ishte konsumuar. Dritaret ishin pa perde, sepse pasi ishin grisur, ato nuk i ishin ndërruar. Boja e mureve ishte e zbehtë, sepse nuk kishte lyer.

Unë u zhvesha dhe hyra në banjë, por ç’të shikoja. Perdet e dushit ishin hequr dhe dushi s’kishte kokë, por vetëm një zorrë e shkurtër që varej sikur të ishte pen*si i Janaqit pas seksit.

Anash pllakës së dushit ishte ngjyrë e zezë, se duhet të ishte një muaj pa e larë.

Pyes në korridor një pastruese filipineze: “Si janë dushet në dhomat e tjera?” dhe ajo më pohoi që ishin njësoj.

U ktheva në dhomë dhe u vesha përsëri.

Shkoj në restorant dhe shoh gjithë turistët që po djersisin. Kthej kokën nga ventilatori qendror, por çfarë shikoj? Ventilatori nuk rrotullohej në terracë, por ishte kthyer nga qoshja ku ishte ulur Janaqi me dashnoren dhe po shijonin një shampanjë Don Perignon.

Ulem diku larg tavolinës së tyre, sepse e qeshura e madhe e saj sikur më priste oreksin.

Një kamarier nga Bangladeshi, që ka tre vjet që shërben aty, më vjen në tavolinë dhe më sjell menunë. Për mirësjellje e pyeta: “Si të shkon puna dhe jeta?”

Ai më pa i heshtur dhe ma ktheu: “Kam një vit që nuk marr rrogën dhe nuk i kam dërguar dot asnjë euro familjes. Ndërkohë, nuk largohem dot, se Janaqi ma ka marrë pasaportën.”

Nejse, pasi hëngra një pasta me fruta deti që natyrisht nuk ishin të freskëta, por të ardhura nga Vietnami, u çova dhe e thirra pak Janaqin për të biseduar.

“Dëgjo”, i thashë, “gjynah që nuk i jep rrogën atij djalit, se është shumë i vuajtur.”

Janaqi ma ktheu: “Po kam blerë jahtin, o valla, nga do i nxirra lekët. Po ky zezaku kot ankohet, se unë të 10 filipinezëve nuk u kam dhënë pagat”

Mbeta pa fjalë. I urova suksese Janaqit në lundrimin e ri drejt oqeanit dhe m’u kujtua koha kur hipte mbi gomar dhe mushka për të transportuar hashash drejt Greqisë.

Ika i trishtuar duke dalë me vështirësi nga parkingu, sepse ishte bllokuar nga parkimi i keq i Porshes së të dashurës së Janaqit, e cila jo vetëm që nuk dinte not, por nuk kishte as patentë makine, por jetonte me ëndrrën e madhe që të dyja do t’ia mësonte Janaqi.

Dola nga parkingu që kushtonte 10 euro dhe i dhashë gaz makinës për t’u larguar me shpejtësi dhe për ta mbyllur këtë sezon turistik me kujtimet e hidhura mbi fitimet e kripura të Janaqëve në bregdetin shqiptar.

Tags: [kreshnik spahiu](#) [Zeqinet](#)

Previous Post

Erion Veliaj del nga qelia, shtrohet në një spital privat



Lajm Lajm


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES